



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KANCELARI

Tiranë, më 26/08/2025

Njoftim për vend të lirë pune

Në mbështetje të Ligjit nr. 53/2019: “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të VKM-së Nr. 821, datë 28.12.2023: “Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të vendimit të Kryesisë të Akademisë së Shkencave, nr.3, datë 10.1.2024: “Për ngritjen dhe organizimin e Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike”, të ndryshuar, të nenit 58, të Statutit të Akademisë së Shkencave, të ndryshuar, të nenit 68, 90 dhe nenit 94, pika 1, gërma a, të rregullores së brendshme administrative, të ndryshuar dhe shkresës Nr. 1142 Prot, datë 14.07.2025, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, shpall vendin e lirë të punës:

“Specialist IT, kategoria e pagës IV-1, pranë Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë”.

I.Kandidatët të cilët kandidojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike si më poshtë:

-Kritere të përgjithshme:

- 1.Të jetë shtetas shqiptar;
- 2.Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 3.Të zotërojë gjuhën e njësuar shqipe, me shkrim e të folur;
- 4.Të jetë në kushte shëndetësore të mira, që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- 5.Të plotësojë kriteret specifike të vendosura në bazë të përshkrimit të vendit të punës për formimin, kualifikimin, përvojën etj.;
- 6.Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që përbën pengesë ligjore;
- 7.Të mos ketë masë disiplinore për largim nga detyra apo që nuk është parashkruar (vetëdeklarim ose vërtetim);
- 8.Të mos ketë masë ndëshkimore në fuqi, nga komisionet e etikës, për shkelje të kodit të kërkuesit shkencor ose mësimdhënësit (vetëdeklarim ose vërtetim);
- 9.Të jetë ose të vendoset me banim në Tiranë.

Kritere specifike:

- 1)Të zotërojnë diplomë të nivelit Master shkencor/ profesional për Informatikë ose Teknologji Informatikë dhe Komunikimi (TIK) apo në degë të tjera të ngjashme;
- 2)Të ketë 3 vjet përvojë pune në profesion;
- 3)Të ketë njohuri në sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave;
- 4)Të ketë njohuri për sigurinë e të dhënave në rrjetet kompjuterike;
- 5)Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze (përbën avantazh).
- 6)Të ketë njohuri mbi dizenjimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e faqes së webi-it;
- 7)Preferohet të ketë trajnime mbi përdorimin e pajisjeve teknologjike të (mjekësisë, antropologjisë, arkeologjisë dhe entit botues);
- 8)Preferohet të ketë njohuri mbi pajisjet e sistemit financiar.

II.Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkursi

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1)Standardet e sigurisë së infrastrukturës dhe telekomunikacionit;
- 2)Rrjetet kompjuterike (LAN, WAN, VPN);
- 3)Sistemin e Serverave/Platformën e Network-ut.

III.Fazat e konkurrimit

Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- 1) verifikimi paraprak i plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta;
- 2) vlerësimi i kandidatëve.

Emri/emrat e kandidatëve që i plotësojnë kriteret (të përgjithshme dhe specifike), publikohet në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave dhe do të njoftohen për zhvillimin e konkursit, sipas parashikimeve të rregullores së brendshme administrative, të ndryshuar.

IV.Vlerësimi

Vlerësimi i kandidatëve bëhet për:

- 1) arsimimin, kualifikimin e aktivitetin e kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin e depozituar në dosje;
- 2) intervistën me gojë;
- 3) pyetësin me shkrim.

Totali i pikëve në vlerësimin e kandidatëve është 100 (njëqind) pikë dhe shpallet fitues kandidati/ja me mbi 60 pikë.

V. Dokumentet dhe afati i dorëzimit

Kandidati/ja që konkuron për këtë vend pune duhet të dorëzojë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me adresë Sheshi “Fan S. Noli”, Tiranë, dokumentet, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Letër motivimi

3. Fotokopje e faqes së parë të pasaportës ose të kartës së identitetit;
4. Curriculum Vitae, me të dhënat personale e profesionale;
5. Fotokopjet e noterizuara të diplomave universitare;
6. Fotokopje e librezës së punës (në të gjitha faqet e saj për të vërtetuar përvojën e punës);
7. Raport mjekësor për aftësinë në punë;
8. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
9. Vërtetim ose vetëdeklarim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Çdo dokumentacion tjetër, i cili vërteton kualifikime, trajnime, arsimin shtesë (nëse ka), mbrojtjen e gjuhëve të huaja etj.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet deri në datën 09.09.2025, ora 16:30.

VI. Detyrat kryesore

Specialisti i IT-së kryen këto detyra kryesore:

- 1) menaxhon sistemet operative të bazuar në Windows;
- 2) instalon dhe mirëmban produktet e Microsoft Office;
- 3) instalon dhe monitoron Antivirusin lokalisht;
- 4) siguron këshillim teknik për planifikim sistemesh;
- 5) konfigurim dhe mirëmban rrjetin kompjuterik, përfshirë kompjutera, ups, printer, skaner;
- 6) përmirëson parametrat e rrjetit dhe sistemeve të komunikimit për të ofruar shërbime cilësore dhe të sigurta;
- 7) planifikon dhe projektin kapacitetet dhe parametrat e rrjetit;
- 8) instalon dhe riparon pjesët fizike të pajisjeve kompjuterike;
- 9) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet.

Ky funksion organik krahas detyrave kryesore të mësipërme, menaxhon sallën “Aleks Buda” dhe “Libri Akademik” me të gjitha instalimet dhe konfigurimet e duhura për zhvillimin normal të aktiviteteve si dhe do të përgjigjet për gatishmërinë e pajisjeve të Entit Botues, pajisjeve të Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës dhe pajisjeve të Laboratorit të Restaurimit në Institutin e Antropologjisë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune do të marrin informacion në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, (www.akad.gov.al) për fazat e mëtejshme të kësaj procedure, në mbështetje të rregullores së brendshme administrative, të ndryshuar.

Adresa: Sheshi “Fan. S. Noli”, Tiranë.